

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RS Design” SHPK

LIRIM SELMANI, i biri i Resul dhe Makbule, lindur në Priskë, Tiranë më 12.11.1944 dhe banues në Vlorë në adresën: Rruga “Panajot Papingji”, Lagjja “10 Korriku”, Ndërtesa Nr.1, SH/K.1, i pajisur me kartë identiteti me Nr.037043515 lëshuar më datë 11.03.2021 me kombësi dhe shtetësi, madhor e me zotësi të plotë juridike, deklaron në këtë **AKT THEMELIMI** si më poshtë :

NENI 1
ORTAKËT THEMELUES

Mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe konkretisht ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", sot më **09.07.2022**, **ORTAK I VETËM THEMELUES** i shoqërisë është shtetasi - **Lirim Selmani**, i cili ka vendosur që kjo shoqëri të marri formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me dispozitat ligjore si më sipër si dhe të **STATUTIT** që i bashkëlidhet këtij **AKT THEMELIMI** .

NENI 2
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë është "**RS Design**"sh.p.k.

NENI 3
FORMA E SHOQËRISË

Ortaku ,Lirim Selmani, vendosi që shoqëria të jetë me përgjegjësi të kufizuar, e thirrur ndryshe sh.p.k.

NENI 4
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria "**RS Design**" shpk do të ketë selinë e saj në Vlorë në Lagjjen "24 Maji",në Zonën Industriale Sodë, Vlorë, Zona Kadastrale 8604, Numri i Pasurisë 39/34, por me vendimin e ortakut të shoqërisë, mund të ngrihen edhe degë, filiale apo dhe zyra përfaqësimi në vende të tjera, brenda dhe jashtë Shtetit Shqipëtar.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së kësaj Shoqërie do të jetë:

- Projektim dhe realizimi i aksesorëve metalikë dhe plastikë për dritare, dyer e vetrata alumini; tregtimi i tyre me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë Shqipërisë; prodhimi për llogari të të tretëve i detaleve, artikujve plastikë e metalikë, montimeve dhe punime mekanike; përpunim i lëndëve të para plastike dhe metalike; si dhe import – eksport i tyre;
- Aktivitet në fushën e tregtisë: Tregëti me shumicë dhe pakicë të artikujve industriale; materialeve dhe pajisjeve elektrike, të materialeve të ndërtimit, artikuj elektroshtëpiake, materiale hidraulike dhe artikuj hidrosanitare dhe çdo lloj artikulli që bën pjesë në kategoritë e mësipërme, import - eksporti i tyre;
- Aktivitet në fushën e transportit: transport për llogari të vetë dhe/ose të tretëve; transport kombëtar dhe ndërkombëtar i mallrave.

Aktivitetet tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë dhe me pakicë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, të luajtshme, të paluajtshme dhe të kryejë çfarëdolloj aktiviteti tjetër të lejuar që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë. Gjithashtu shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri dhe/ose kooperativa, ndërmarrje të çdo natyre që kanë objekt të njëjtë apo që lidhet me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 6 NDRYSHIM I OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË

Me zgjerimin e aktivitetit, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "**RS Design**" sh.p.k mund të bëjë shtesa të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 7 KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë "**RS Design**" sh.p.k do të jetë me një afat kohor të pacaktuar.

NENI 8 KAPITALI FILLESTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është caktuar në LEKË 100.000 (njëqindmijë) dhe është tërësisht kapital financiar i ortakut themelues në raportin:

- Lirim Selmani 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është LEKË 100.000 (njëqindmijë) dhe ndahet në 1 (një) kuota me vlerë nominale 100.000 (njëqindmijë), që përbën 100 % (një qind për qind) të

kapitalit të shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe derdhur tërësisht nga ortaku si vijon:

Lirim Selmani zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë ekuivalente me 1 (një) kuotë të kapitalit, ekuivalente me LEKË 100.000 (njëqindmijë) në kapitalin e shoqërisë;

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve kapitali mund të rritet ose zvogëlohet sipas formave të parashikuara nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë-tregtare".

NENI 9 ORGANI VENDIMARRËS DHE ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë ortaku Lirim Selmani për periudhën nga data e regjistrimit deri më 09.07.2027.

Organi i vetëm vendim-marrës është Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "**RS Design**" sh.p.k .

Organet drejtuese janë :

- Asambleja e Përgjithëshme e shoqërisë e cila përbëhet nga :
Ortaku Lirim Selmani
- Administratori i Përgjithshëm Lirim Selmani.

NENI 10 NËNSHKRIMI

Ky **AKT THEMELIMI** u nënshkrua në pesë kopje të barazvlefshme të tij, sot më datë **09.07.2022**.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "RS Design" sh.p.k :

1. LIRIM SELMANI _____

